



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:004769
Datë: 13.06.2024
Numri i dokumentit: 05821334

C.nr.32/2021

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si kontestimore me gjyqtari individual Blerim Istrefi, në çështjen juridike të paditëses: H.SH nga M..., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Isa Hyseni av në Mitrovicë, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës-D...K...e Shëndetësisë, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Mitrovicë, për shkak të kompensimit të ardhurave në emër të shpërblimit jubilar, jashtë seance konform nenit 398 të LPK-së, me dt.13.06.2024 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses H.SH nga M..., **OBLIGOHET** e paditura Komuna e Mitrovicës-D...K...e Shëndetësisë, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Mitrovicë, që paditëses H.SH, në emër të pagesës për shpërblim jubilar si e punësuar te e paditura për 20 vite të përvojës së punës në vlerë të dy (2) pagave bazë në shumën prej 818.84 €, (tetëqind e tetëmbëdhjetë euro e tetëdhjetekatër cent)(409.42 x 2 =818.84 euro), të gjitha me kamat ligjore prej 8% nga data 13.01.2021 e deri në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

II. OBLIGOHET e paditura Komuna e Mitrovicës-D...K...e Shëndetësisë, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Mitrovicë, t'ia paguajnë paditëses shpenzimet e procedurës në shumë prej 124.00 €, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi me datën 12.09.2019 ka ushtruar padi e të precizuar për kompensimin e të ardhurave në emër të shpërblimit jubilar dhe atë në emër të 2 paga duke u bazuar në nenin 17 par.3 nen par. 3.2 te Kontratës Kolektive Sektoriale, shumën prej 818.84 €, me kamat ligjore prej 8% nga ushtrimi i padisë e deri ne pagesën definitive te detyrimit. Shpenzimet i ka kërkuar dhe atë për përpilim te padis shumen prej 104 € si dhe 20 € në emër te4 taksës gjyqësore për padi.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi me datë 09.10.2023, të cilin e padituri e ka pranuar me datë 16.10.2023(e cila është konfirmuar përmes fletë kthesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës).

Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurin për detyrimin ligjor për dhënie të përgjegjës në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes - pa dëgjueshmërisë.

E padituri, brenda afatit ligjor me datën 30.10.2023 pranë kësaj gjykata ka paraqitur përgjigje në padi dhe i njëjti ka deklaruar se e konteston në tërësi kërkesëpadinë si të pabazuar me arsyetimin se kontrata sektoriale nuk është nënshkruar nga e paditura dhe si e tillë nuk prodhon efekt juridik për të njëjtën, po ashtu ka shtuar se e paditura nuk ka legjitimitet real pasiv në këtë procedurë, andaj ka kërkuar që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet në tersi si e pa bazuar.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e provave të bashkangjitura padisë, si dhe pas pranimit të përgjigjes në padi, mbështetur në nenin 8 dhe 398 të LPK-së, dhe në këtë rast gjykata ka vlerësuar se nuk ka pengesa në kuptim të dhënies së vendimit meritor jashtë seance.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se: Në mes palëve ndërgjyqësve nuk është kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, megjithatë gjykata këtë e vërtetoi, nga provat e bashkangjitura padisë dhe atë:

Nga Kontrata e punës e dt. 01.04.2013 e lidhur në mes paditëses dhe te paditurës dhe nga vërtetimi mbi përvojën e punës të lëshuar nga QKMF “...” Mitrovicë i dt. 09.12.2020, vërtetohet fakti se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura nga data 01.09.1999 e tutje, kurse nga qarkullimi bankar i lëshuar nga BKT njësia Mitrovicë, dëshmohet lartësia e pagës që e ka realizuar paditësja në lartësi prej 409.42 €.

Andaj, lidhur me kompensimin e pagave jubilarë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi dhe ka obliguar të paditurën që paditëses t’ia kompensoj shumën e përcaktuara si në pikën I, pasi që u vërtetua fakti se paditësja kishin punuar te e paditura dhe ende vazhdojnë të punojnë, dhe të njëjtës nuk i është paguar kompensimi në emër të shpërblimit jubilar, të parapara me nenin 17 par 3 nën par. 3.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë me të cilën parashihet se “Punëmarrësi i cili për 20 vjet radhazi dhe pandërprerë të përvojës se punës në institucione shëndetësore i njihet e drejta në shpërblim jubilar në vlerë-lartësi të dy pagave mujore të tij”, e në rastin konkret paditëses është e punësuar tek e paditura për 21 vite, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Bazuar në nenin 17 par.4 të kontratës se lartcekur është detyrim i punëdhënësit të fundit këtu të paditurës që t’i paguaj kompensimin për shpërblim jubilar.

Ndërsa lidhur me pretendimet e të paditurës të dhëna në përgjigjen në padi, se kontrata sektoriale nuk është nënshkruar nga e paditura dhe si e tillë nuk prodhon efekt juridik për të njëjtën, po ashtu ka shtuar se e paditura nuk ka legjitimitet real pasiv në këtë procedurë, te njëjtat pretendime gjykata i refuzoj si të pabazuar konform dispozitës 17 par.4 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë.

Gjykata me rastin e vendosjes si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ju referua edhe nenit 245 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”. Rrjedhimisht, duke qenë se e paditura i ka mbetur borxh paditëses, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën, që paditëses t’ia kompensoj shumën si në pikën I të dispozitiv të aktgjykimit.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së dhe Mendimit Juridike të Gjykatës Supreme të Kosovës për kamatën nr.265/2020 të datës

01.12.2020, ka marr datën e ushtrimit të padisë (data 13.01.2021), e ku lartësia e kamatës vjetor është e definuar 8% deri në pagesën definitive të detyrimit.

Gjykata vendosi si në piken II te dispozitivit, në kuptim të nenit 452 të LPK-së ashtu që e detyrohet e paditura të paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilimin e padisë shumë në lartësi prej 104.00€ - sipas tarifës së OAK, si dhe ne emër te taksës gjyqësore shumen prej 20.00 €.

Gjykata, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke i'u referuar dispozitës së nenit 398 të LPK-së, e në lidhje më dispozitat e nenit 17 par.3.2 dhe par4 te të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, dhe dispozitave të nenit 245 par.1 dhe 2, 249 par.1 dhe 2 dhe 382 të LMD-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROIVCË
Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Civil
C.nr.32/2021 me datë 13.06.2024

GJYQTARI
Blerim Istrefi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.